

**KONTRATE PER SHITJEN E KUOTES
(ME KUSHT)**

Sot me date 17.07.2023 ne Tirane midis paleve te meposhtme:

Nga njera ane:

- 1. Shoqeria Investment Joti-InfoSoft Group sh.p.k**, e regjistruar me date 25.02.2009, ne Qendren Kombetare te Biznesit, me NUIS K91425022E, e perfaqesuar nga Administratorja Znj. Blerta Elezaj, e cila zoteron nje kuote qe perfaqeson 55% te kapitalit te regjistruar te Shoqerise Info Business Solutions shpk;
(ne vijim referuar si **"Shitesi"**)

Nga ana tjeter:

- 2. Z.Armand Shara**, shtetas Shqiptar, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, me adrese: Rr.Sami Frasheri; Nd. 1818; H. 1; Ap. 003; Njesia Administrative Nr. 5; Njesia Bashkiake Nr. 5; Tirane, lindur me 09/07/1971, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me pasaporte me nr. BC4215342 dhe nr. personal H10709088K;

E pranishme :

Znj.Edlira Shara, shtetase Shqiptare, lindur ne Tirane dhe banuese ne Tirane, me adrese Rruga"Sami Frasheri"; Nd. 1818; H. 1; Ap. 003; Njesia Administrative Nr. 5; Njesia Bashkiake Nr. 5; Tirane, lindur me 26/11/1970, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me Leternjoftim ID nr. 034929953 dhe nr. personal H06126023G, e cila jep pelqimin dhe miratimin e saj per nenshkrimin e kesaj Kontrate.

Dhe

- 3. Z.Bledar Dhima**, shtetas Shqiptar, lindur ne Kuçove, Berat dhe banues ne Tirane, me adrese Rr.Faik Konica; Nd. P.Kulla 2; Ap. Ap.23; Njesia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tirane, lindur me 28/02/1970, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me pasaporte me nr. BR0013376 dhe nr. personal H00228125G

E pranishme :

Znj.Mirela Dhima, shtetase Shqiptare, lindur ne Durres dhe banues ne Tirane, me adrese Rr. Faik Konica; Nd. P.Kulla 2; Ap. Ap.23; Njesia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tirane, lindur me 28/08/1974, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me pasaporte me nr. BR9998160 dhe nr. personal H45828045A.

(ne vijim te gjithe se bashku referuar si **"Bleresit"**)

DUKE QENE SE:



- A. Shoqeria Info Business Solutions shpk, eshte nje shoqeri shqiptare me pergjegjesi te kufizuara, ku vlere totale e kapitalit te regjistruar dhe te paguar te shoqerise eshte 9,788,814.00 leke (nentemilion e shtateqind e tetedhjetë e tetemije e teteqind e katermbedhjetë leke), regjistruar sipas legjislacionit shqiptar ne Qendren Kombetare te Biznesit, me 14.10.2010, me NUIS L02214022G dhe seli ne Rruga "Murat Toptani", Gjergji Center Tirane ("**Shoqeria**");
- B. Shitesi deshiron qe te shese te gjithë kuoten qe zoteron ne kapitalin e Shoqerise, e cila perfaqeson 55% te kapitalit, dhe ka vlere nominale te regjistruar prej 5,383,847.70 (pese milion e treqind e tetedhjetë e tre mije e teteqind e dyzete e shtate presje shtatedhjetë) Leke ("**Kuota IJ-IG**" ose "**Kuota ne Shitje**");
- C. Bleresit deshirojne te blejne Kuoten ne Shitje, si vijon:
- (i) **Z. Armand Shara** blen nje pjese te Kuotes ne Shitje qe perfaqeson **36,663%** te kapitalit te Shoqerise Info Business Solution shpk; dhe
 - (ii) **Z. Bledar Dhima** blen nje pjese te Kuotes ne Shitje qe perfaqeson **18,337%** te kapitalit te Shoqerise Info Business Solution shpk.
- D. Pas kalimit te pronesise se Kuotes ne Shitje tek Bleresit, sipas percaktimeve ne kete kontrate, Shitesi largohet nga Shoqeria dhe Bleresit mbeten ortakët e vetem te Shoqerise, si vijon:
- (i) Z.Armand Shara zoteron 36,663% te kapitalit te Shoqerise.
 - (ii) Z. Bledar Dhima zoteron 33,337% te kapitalit te Shoqerise.
 - (iii) Shoqeria TAG Engineering shpk zoteron 30% te kapitalit te Shoqerise.

Atehere, palet ne kete kontrate ("**Kontrata**") bien dakord si me poshte:

1. OBJEKTI I KONTRATES

- 1.1 Objekt i kesaj kontrate eshte shitja dhe transferimi i Kuotes ne Shitje ne pronesi te Bleresve ne Shoqeri nga Shitesi tek Bleresit sipas kushteve te kesaj kontrate dhe sipas percaktimeve ne paragrafin C ketu me siper.
- 1.2 Pronesia e Kuotave ne Shitje kalon tek Bleresit pas pagimit te vleres se plote te çmimit te shitjes sipas kushteve dhe detyrimeve te kesaj Kontrate dhe pjeset e Kuotes ne shitje do te shiten dhe blihen se bashku me te drejtat dhe perfitimet e lidhura me to.
- 1.3 Me kalimin e pronesise se Kuotes ne Shitje ne pronesi te Bleresve, kapitali i Shoqerise do te zoterohet nga ortakët e Shoqerise, si vijon:
- (i) **Z.Armand Shara zoteron 36,663% te kapitalit te Shoqerise.**
 - (ii) **Z. Bledar Dhima zoteron 33,337% te kapitalit te Shoqerise.**
 - (iii) **Shoqeria TAG Engineering shpk zoteron 30% te kapitalit te Shoqerise.**

2. CMIMI I BLERJES SE KUOTAVE DHE MENYRA E PAGESES

- 2.1 Çmimi i Kuotes ne Shitje qe do te paguhet nga Bleresit eshte i ndryshem nga vlere nominale e kuotes.
- Ne total çmimi i shitjes se Kuotes se Shitesit eshte 299,083,848 (dyqind e nentëdhjetë e nente milion e tetëdhjetë e tre mije e teteqind e dyzete e tete) Leke dhe do te paguhet si me poshte vijon:
- (i) **Z.Armand Shara** do te paguaje ne favor te shoqerise Investment Joti – Infosoft Group shpk vleren prej **199,369,293 (njqind e nentëdhjetë e nente milion**



e treqind e gjashtedhjetë e nente mijë e dyqind e nentëdhjetë e tre) Leke.

(ii) Z.Bledar Dhima do të paguaje në favor të shoqërisë Investment Joti – Infosoft Group shpk vlerën prej **99,714,555 (nëntëdhjetë e nente milion e shtatëqind e katërmëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) Leke.**


- 2.2 Blerësit do t'i paguajnë Çmimin e Blerjes Shitesit brenda 3 (tre) vjetësh nga Data e Kontrates, me anë të transferimit të shumës perkatese në llogarinë bankare që Shitesit do t'ua njoftojë Blerësve.
- 2.3 Në rast se Çmimi i Blerjes nuk paguhet në llogarinë e Shitesit sipas parashikimeve të nenit 2.2, Shitesit ka të drejtë që të kërkojë zgjidhjen e kësaj kontrate, Kuoten në Shitje dhe të mbajë pjesën e çmimit të paguar nga Blerësit deri në ditën e deklarimit të zgjidhjes së kontrates.
- 2.4 Në rast se vetëm njëri nga Blerësit nuk ka likuiduar çmimin e blerjes së pjesës së tij të kuotes, atëherë zgjidhja e kontrates do të ketë efekt vetëm kundrejt Blerësit që është në mospermbushje.
- 2.5 Për të shmangur çdo dyshim, kontrata do të konsiderohet e zgjidhur kur nuk është likuiduar çmimi i blerjes së Kuotes dhe Shitesit këtë fakt e deklaron në deklaratën e njëanshme të nënshkruar prej tij për zgjidhjen e kontrates. Në çdo rast, palët kanë të drejtë të bëjnë amendimin e dispozitave të kësaj kontrate, përfshirë edhe afatin e likuidimit të çmimit të blerjes së Kuotes, por kjo do të realizohet vetëm me vullnetin e përbashkët të të gjitha palëve nënshkruese.

3. KALIMI I PRONESISE SË KUOTAVE NË SHITJE

- 3.1 Pronesia mbi Kuotat në Shitje i kalon Blerësve pas likuidimit të plote nga secili prej tyre i çmimit të plote të kësaj Kontrate.
- 3.2 Blerësit kanë të drejtë të depozitojnë vullnetarisht këtë Kontratë pranë Qendres Kombëtare të Biznesit brenda 30 ditësh kalendarike nga Data e Kontrates. Pas kalimit të pronësive mbi Kuotat në Shitje sipas paragrafit 3.1 më sipër, Blerësit kanë detyrimin të bëjnë depozitim të detyrueshëm të kësaj kontrate në regjistrin tregtar dhe në Regjistrin e Pronarëve Përfutur, me qëllim ndryshimin e strukturës së pronësive të shoqërisë Info Business Solutions shpk dhe plotësimin e detyrimeve ligjore në fuqi.

4. DEKLARIMET E GARANCITË E SHITESIT

- 4.1 Shitesit deklaron dhe garanton ndaj Blerësit dhe në favor të secilit prej tyre se secila nga garancitë dhe deklaratimet ("**Garancitë e Shitesit**") në vijim janë të vërteta dhe të sakta në Datën e Kontrates.
- 4.2 **Personaliteti juridik i Shoqërisë:** Shoqëria është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar, regjistruar dhe që vepron në përputhje me Ligjin e zbatueshëm, e regjistruar në të gjitha organet perkatese shtetërore të regjistrimit në Republikën e Shqipërisë. Ajo gëzon zotësi të plote juridike dhe ka zotësi të fitoje të drejta dhe të marrë përsipër detyrime, të perdore dhe gezojë pasuritë në pronësi apo përdorim të saj si dhe për të kryer e përmbushur objektin e saj të veprimtarisë ekonomike.
- 4.3 **Statusi Aktiv:** Shoqëria nuk ndodhet në gjendjen e paafetësisë paguese dhe ka aftësi të mbulojë detyrimet e saj që behen të kerkueshme për 12 muajt e ardhshëm, nuk është marrë asnjë vendim dhe nuk është ndermarrë asnjë veprim nga Shoqëria,



Shitesi apo te trete per likuidimin vullnetar apo te detyruar te Shoqerise ne perputhje me Ligjin e zbatueshem Tregtar dhe te falimentimit, gjithashtu nuk eshte marre asnje vendim dhe s'eshte ndermarre asnje veprim nga Shoqeria, Shitesve apo te trete per ri-organizimin e e biznesit te Shoqerise ne dobi te kreditoreve, per ristrukturimin, shnderrimin, bashkimin apo ndarjen e Shoqerise apo transferimin e biznesit te saj apo pjeseve te tij tek te trete. Nuk eshte caktuar asnje likuidator apo administrator i posacem falimentimi nga Shitesi, Shoqeria apo te trete dhe s'eshte ndermarre ndonje vendim per caktimin e tij.

- 4.4 **Pronesia e Kuotes:** Kuota ne Shitje eshte e lire e shkarkuar nga cdo Barre e cfaredolloj forme qofte dhe Shitesi ka te drejte dhe zotesi te plote per te shitur dhe transferuar pronesine mbi te ne perputhje me kete Kontrate.
- 4.5 **Filialet:** Shoqeria nuk ka asnje Filial apo dege ne Shqiperi apo cdo vend tjeter dhe nuk ka asnje pjesemarrje e cila i jep kontroll ose jo mbi persona ne Shqiperi apo jashte saj.
- 4.6 **Pasqyrat Financiare.** Pasqyrat Financiare te Shoqerise per vitin 2022 paraqesin nje pasqyre te sakte, te vertete dhe te plote te gjendjes financiare te Shoqerise per periudhen e mbuluar prej tyre dhe jane pergatitur ne perputhje me Parimet e Kontabilitetit te zbatuara ne menyre te qendrueshme.
- 4.7 **Regjistrimet Kontabel:** Te gjitha transaksionet financiare te Shoqerise jane regjistruar dhe pasqyruar ne menyre te plote dhe te sakte ne librat dhe regjistrat kontabel te Shoqerise ne perputhje me praktikat zakonore te mira te pranuar per kete qellim dhe keto regjistrime kane sherbyer si baze per perpilimin e Pasqyrave Financiare. Te gjitha informacionet, regjistrimet, librat kontabel apo sistemet qe kane lidhje me veprimet financiare dhe administrimin e biznesit te Shoqerise jane ne posedim te Shoqerise dhe ruajtja, posedimi apo mirembajtja e tyre nuk varet nga persona te trete.
- 4.8 **Asetet e Shoqerise:** Shoqeria gezon titull te paster pronesie apo perdorimi, te tregtueshem dhe shkarkuar nga cdo Barre mbi pasurite e luajtshme te preکشme te paprekshme te pasqyruara ne Pasqyrat Financiare, Shoqeria gezon titull te paster pronesie apo perdorimi, te tregtueshem dhe shkarkuar nga cdo Barre mbi te gjitha asetet e tjera qe jane te nevojshme per objektin e veprimtarise se Shoqerise.
- 4.9 **Kontratat Kryesore te Shoqerise.** Shoqeria nuk eshte pale dhe nuk ka marre persiper te jete pale e ndonje kontrate apo marreveshjeje kredie apo huaje.
- 4.10 **Veprimtaria e Shoqerise eshte ne perputhje me Ligjin.** Shoqeria dhe Administratori i saj kane vepruar dhe veprojne ne perputhje me Ligjin e zbatueshem. Shoqeria ka kryer e depozituar rregullisht te gjitha deklarimet tatimore dhe ka paguar gjithmone ne kohe te gjitha taksat dhe tatimet e zbatueshme ndaj Shitesit, Shoqerise, punemarresve pasurive e aseteve te saj, ne perputhje me Ligjin e zbatueshem ne Shqiperi ne cdo kohe, me perjashtim te taksave e tatimeve qe jane per t'u paguar deri ne Daten Permbyllese, pa vonese dhe penalitete. Vendimet e asamblese se ortakeve te Shoqerise dhe Administratoreve te saj jane marre, regjistruar dhe ruajtur ne menyre te rregullt ne seline e Shoqerise ne perputhje me Ligjin Tregtar dhe pasqyrojne ne menyre te sakte dhe te vertete te gjitha vendimet te cilat sipas Ligjit te zbatueshem duhet te trajtohen ne keto vendime nga asambleja apo Administratoret e Shoqerise. Shoqeria dhe Administratori i saj kane vepruar gjithmone dhe veprojne ne perputhje me Ligjin e zbatueshem per pastrimin e parave, nuk jane denuar ndonjehere per

ndonje veper penale ne Shqiperi apo vend tjetër, nuk jane te pandehur apo hetim dhe ndjekje penale ne Shqiperi apo vend tjetër.

- 4.11 **Proceset Gjyqesore dhe Administrative:** Shoqeria nuk eshte e perfshire ne asnje proces gjyqesor apo administrativ per shkelje te detyrimeve ligjore ne fuqi ne Shqiperi apo jashte saj.
- 4.12 **Punesimi:** Shoqeria ka vepruar dhe vepron ne perputhje me Ligjin e zbatueshem ne lidhje me punemarresit e saj, duke perfshire por jo vetem, ato qe lidhen me lidhjen e nje kontrate pune te rregullt, pagat, oret e punes, sigurine dhe shendetin ne pune, pagesat e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore, etj
- 4.13 Shitesit detyrohet te demshperbleje Bleresit apo Shoqerine, ne cdo kohe si pasoje e:
- a) ngjarjeve, rrethanave apo fakteve te cilat kane lindur, ndodhur apo vertetuar perpara nenshkrimet te kontrates kryesore te shitjes dhe gjate kohezgjatjes se vlefshmerise se kontrates se opsionit; ose
 - b) ngjarjeve, rrethanave apo fakteve qe kane lidhje me veprime apo mosveprime te Shitesit, Shoqerise apo Administratoreve e punemarresve te Shoqerise perpara nenshkrimet te kontrates kryesore te shitjes dhe gjate kohezgjatjes se kontrates se opsionit; ose
 - c) ngjarjeve, rrethanave apo fakteve qe jane ne kundërshtim apo nuk perputhen ne menyre te plote apo te pjesshme me Garancite e deklarimet e Shitesit te ofruara ndaj Bleresve ne kete Kontrate duke perfshire por pa u kufizuar vetem ne to garancite dhe deklarimet ne lidhje me mungesen e pretendimeve te te treteve ndaj Shoqerise dhe/ose detyrime te Shoqerise per Taksa/Tatime, me perjashtim te atyre te parashikuara shprehimisht ne kete Kontrate dhe Anekset e saj;

5. DEKLARIMET E GARANCITE E BLERESIT

- 5.1 Bleresit, paraqesin dhe garantojne ndaj Shitesit dhe ne favor te tij, se secila nga garancite dhe deklarimet ne vijim jane te verteta dhe te sakta ne daten e nenshkrimet te kesaj kontrate dhe ne daten e transferimit te pronesise mbi Kuoten ne Shitje.
- 5.2 Bleresit gezojne te gjitha te drejtat, autoritetin dhe aftesine ligjore per te lidhur kete Kontrate dhe per te perfunduar transaksionet per te cilat eshte rene dakord ne perputhje me kushtet e kesaj Kontrate.
- 5.3 Bleresit pranojne se perpara nenshkrimet te Kontrates u eshte dhene mundesi e plote per te marre informacionin e nevojshem ne lidhje me Shoqerine ne menyre qe te marre nje vendim te informuar ne lidhje me kete transaksion, duke qene se jane ortake te Shoqerise dhe kane marre pjese ne manaxhimin e saj dhe rrjedhimisht, jane te njohur me gjendjen ekonomike, financiare dhe ligjore te saj dhe kjo duhet te merret parasysh ne cdo rast ne lidhje me çfaredolloj pretendimi qe ata mund te kene tani dhe ne te ardhmen ne lidhje me Garancite dhe Deklarimet e Shitesit ne Nenin 4 ketu me siper te kesaj Kontrate.

6. DETYRIMET E BLERESIT

- 6.1 Bleresit detyrohen qe te kryejne pagesen e Çmimit te Blerjes sipas menyres se percaktuar ne Nenin 2 te kesaj Kontrate, si dhe te bejne depozitim te kontrates prane Regjistrat Tregtar dhe Regjistrat te Pronareve Perfitues.

7. DEMSHPERBLIMI



Four handwritten signatures in blue ink are visible at the bottom of the page. The signatures are stylized and appear to be of different individuals.

- 7.1 Ne rast se Bleresit nuk permbushin detyrimet e tyre ne kete Kontrate dhe/ose shkelin deklarimet dhe garancite e dhena ne Nenin 5 te cilat pamundesojne permbushjen e objektit dhe qellimit te kesaj Kontrate, atehere Shitesi, pervec te drejtave sipas Nenit 2 te kesaj Kontrate, ka te drejte te zgjidhe Kontraten dhe te kerkoje çdo humbje, interesa apo demshperblim tjeter si pasoje e mospermbushjeve apo shkeljeve te Bleresve.

8. PERFAQESIMI I SHOQERISE IJ-IG NE MBLEDHJET E APO TE SHOQERISE INFO BUSINESS SOLUTIONS SHPK

- 8.1 Palet bien dakord qe Z.Bledar Dhima do te emerohet si perfaqesues i posaçem i shoqerise Investment Joti – Infosoft Group shpk, i cili do te autorizohet te perfaqesoje ligjerisht shoqerine Investment Joti – Infosoft Group shpk, me te gjitha tagrat, ne prezencen ose ne mungesen e saj, ne marredheniet me shoqerine Info Business Solutions shpk, ne marredheniet me administrimin, administratorin/et e kesaj shoqerie, si dhe ne mbledhjet e zakonshme dhe te jashtezakonshme te Asamblese se Pergjithshme te shoqerise Info Business Solutions shpk, deri ne plotesimin e kushtit per transferimin e pronesise sipas kesaj Kontrate per Shitblerjen e Kuotes.

9. KOSTOT

- 9.1 Secila Pale merr persiper kostot e saj lidhur me negociaten, mbylljen dhe nenshkrimin e dokumentave te detyrueshme ligjerisht ose sipas kontratave per shitjen e Kuotave ne Shitje.
- 9.2 Cdo tarife, takse ose tatim qe duhet paguar nese ka te tille si rezultat i nenshkrimit te kesaj Kontrate dhe i kalimit te Kuotes ne Shitje, merret persiper nga pala qe eshte e detyruar me ligj dhe, ne rast se ligji nuk percakton se kujt pale i ngarkohen, ato ndahen ne menyre te barabarte midis paleve.

10.LIGJI I ZBATUESHEM


- 10.1 Kjo Kontrate dhe marredheniet midis Paleve do te rregullohen nga legjislacioni shqiptar, dhe do te interpretohet ne perputhje me ligjet shqiptare.

11.JURIDIKSIONI

- 11.1 Cdo mosmarreveshje qe lind nga ose ne lidhje me kete Kontrate persa i perket zbatueshmerise ose vlefshmerise do te zgjidhet perfundimisht nga gjykata kompetente shqiptare.

12.TE NDRYSHME DHE SHTESA

- 12.1 Asnje ndryshim, shtese, ose tjetersim i kesaj Kontrate nuk do te jete e vlefshme nese nuk eshte me shkrim ne nje dokument te vetem te nenshkruar nga ose per llogari te Paleve.



- 12.2 Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe, te drejtat dhe detyrimet sipas kesaj Kontrate do t'u kalojne, ne rastet e parashikuara nga ligji apo kjo kontrate, te gjitha pasuesve, zevendesuesve ose trashegimtareve te paleve.
- 12.3 Ne rast se ne çdo kohe ndonje prej dispozitave te kesaj Kontrate eshte ose behet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme, atehere kjo dispozite do te konsiderohet e pavarur nga kjo Kontrate dhe nese eshte e mundur do te zevendesohet nga nje dispozite e vlefshme, e cila do te shprehe, sa me afer te jete e mundur, qellimin e Paleve sipas kesaj Kontrate dhe aty ku eshte e mundur nuk do ndikojte ose demtoje vlefshmerine apo zbatueshmerine e ndonje dispozite tjeter te Kontrates.

13.GJUHA, KOPJET E KONTRATES DHE HYRJA NE FUQI

Kjo Kontrate hartohet ne 5 (pese) kopje ne gjuhen shqipe, secila prej tyre do te konsiderohet origjinale, por te gjitha bashke do te perbejne nje dhe te njejten marreveshje.

PALET

SHITESI:

Investment Joti - Infosoft Group shpk

Znj.Blertha ELEZAJ
Administratore e Pergjithshme



BLERESIT:

Z.Armand SHARA

Jep pelqim:

Znj. Edlira Shara

(Bashkeshortja e Z.Armand Shara)

Z. Bledar DHIMA

BLEDAR DHIMA

Jep pelqim:

Znj. Mirela Dhima

(Bashkeshortja e Z.Bledar Dhima)